

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **10.04.2020** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989 ”** të kandidatit **MA. Sedat Sahitaj**

Në bazë të vendimit **16-323/2** të datës **10.04.2020**, Komision i përbërë nga: **Prof. dr. Fehari Ramadani** (kryetar), **Prof. dr. Zeqirja Idrizi**, **Prof. dr. Zeqirja Rexhepi**, **Prof. dr. Isak Sherifi** (anëtarë) dhe **Prof. dr. Nebi Dervishi** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

REFERAT

Të dhëna biografike për kandidatin

MA. Sedat Sahitaj, i lindur më 28.05.1981 në fshatin Bubël Malishevë Republika e Kosovës. Në vitin akademik **2000-2001 - 2004-2005** kam ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik në UP në Prishtinë dega e Historisë, ku kam marrë gradën profesor i shkencave historike.

2006-2009 kam përfunduar studimet MASTER në fushën e Historisë Moderne me temën: “Ushtritë e monarkive ballkanike deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore”. Në vitin akademik **2015/2016**, vazhdoi studimet e ciklit të tretë në

Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, në drejtimin: Historinë e popullit shqiptar- periudha bashkëkohore.

Shtator 2009 -2012 Gjimnazin “Abdyl Frashëri” në Malishevë, lektor i Lëndës së Historisë. **Shtator 2010-s** vazhdoj të punoj pranë Qendrës së Kompetencës në Malishevë, në të cilën është lektor i lëndës së Trashëgimi Kulturore dhe Historike. **Shtator 2010 –shtator 2014** njëkohësisht ka qenë menaxher i departamentit të Hotelerisë dhe Turizmit në Qendrën e Kompetencës. **2016** po ashtu ka qenë i angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Është autor i një monografie të botuar dhe disa punimeve shkencore nga fusha e historisë.

Informacione lidhur me lëndën e hulumtimit

Studimi i kandidatit Sedat Sahitaj “**Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989**” është një prurje e re shkencore për periudhën në fjalë, i mbështetur kryesisht në dokumente autentike arkivore të proveniencës shqiptare por edhe të Arkivit të Lubjanës.

Pra studimi është mbështetur kryesisht nga vjelja e një materiali voluminoz dhe kualitativ burimor i arkivave dhe të një literature mjaft të përzgjedhur, çdo herë duke përdorur klasifikimin si metodë, më qëllimin e vetëm që të bëhet analizë sa më e saktë e ngjarjeve. Kandidati ka shfrytëzuar fondet arkivore të Arkivit Qendror të Shteti Shqiptar, fondet e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtëm të Shqipërisë (AMPJ), fondet e Agjencisë së Arkivave të Kosovës, fondet e Arkivit të Lublanës(Arhiv Republike Slovenije,fondi:

Централни комитет Комунистичке лиге, Škatla 872-KOSOVO), si dhe mjaft vëllime të dokumenteve të botuara të arkivave të huaja dhe vendore, shtypin e kohës, memoaret etj., njëkohësisht ky është edhe bazamenti i këtij punimi të doktoratës. Sa i përket literaturës që ka shfrytëzuar kandidati për këtë studim doktrate, është një gamë bukur e gjerë. Literaturën që ka përdorur kryesisht është ajo që flet për segmente të veçanta të temës, në një formë ose tjetër, si dhe shkrime të kohës për temën që kemi pasur në shqyrtim, të autorëve të huaj dhe atyre vendor. Me një kujdes të veçantë ka shfrytëzuar edhe burimet nga interneti, kryesisht libra të autorëve të huaj. Krejt këtë gërshetim që ka bërë kandidati ka pasur si objektiv të vetëm për të qenë sa më afër të vërtetës historike për periudhën 1974-1989. Prandaj më të drejtë mundem me konstatua se punimi në fjalë ka një bazament të mirëfilltë bibliografik.

Kandidati Sahitaj, ka trajtuar këtë periudhë historike 1974-1989 duke i nisur nga e përgjithshmja tek e veçanta, pra është kthyer prapa më në thellësi të historisë, aty ku edhe kanë zanafillën shumica e ngjarjeve të periudhës në fjalë. Pra është kthyer në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, duke trajtuar gjendjen politike, ekonomike, juridike dhe sociale të Kosovës që nga vitit 1945-1966. Krejt kjo për të pasur një lidhshmëri sa më të qartë të ngjarjeve që ka pasur për studim 1974-1989.

Prandaj në formulimin e përmbajtjes së temës kandidati ka trajtuar shumë nga segmentet dhe ngjarjet që kanë karakterizuar periudhën 1974-1989. Studimi përbëhet nga një ndërlidhje e mirë, ku janë shfrytëzuar shumë dokumente autentike arkivore, siç e cekëm edhe më lartë të proveniencës shqiptare por edhe asaj jugosllave. Më pastaj është shfrytëzuar një gamë e gjerë të literaturës të autorëve ndërkombëtar dhe autorëve vendor, që trajton segmentet e periudhës që kemi për studim, dhe çdo herë duke pasur parasysh metodën krahasimtare. Po ashtu duke pasur parasysh çdo herë shtypin e kohës dhe kujtimet e personaliteteve kyç të kohës. Formulimi bazik i temës së kandidatit që ka pasur në studim është pikërisht ky material që kemi cekur më lartë. Me të drejt si mentor mundem me konstatua se punimi ka një bibliografi mjaftë të pasur.

Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni

Jo vetëm në historiografinë shqiptare, por edhe në historiografinë serbe, perëndimore etj., kanë zgjuar interesim të shumë studiuesve periudha 1974-1989. Pra për shkak të ngjarjeve karakteristike që determinuan edhe politiken në ish-Jugosllavi dhe në shtetin shqiptar, ka bërë që studiues nga shumë vende të merren me studimin e shumë segmenteve të kësaj periudhe kohore. Kandidati ka shfrytëzuar gjithë këtë gamë të gjerë të literaturës, duke shfrytëzuar me një kujdes të veçantë, duke i ballafaquar faktet e autorëve që kanë trajtuar këto segmente. Por nuk vërehet askund që kandidati të ketë ra nën ndikim e ndonjë studiuesi vendor apo të huaj, ka ruajtur në përpikëri paanshmërinë, pra nuk ka ra në grackën e diletantizmit.

Kjo periudhë historike është shumë e ngjeshur me ngjarje të rëndësishme sidomos për shqiptarët në Kosovë, por jo vetëm po ashtu edhe për ish-Jugosllavin dhe shtetin shqiptar.

Vitet 1974-1989 për shqiptarët nuk ishte një periudhë shumë e gjatë historike në kuptimin kalendarik, por ishte mjaft dinamike, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, po ashtu ishte edhe mjaft me rëndësi për qenien e tyre. Në Kosovë gjatë viteve 70-ta shqiptarët fillojnë të kenë disa të drejta, të cilat iu kishin mohuar që në krye të herës. Këto të drejta i fituan me kushtetutën e vitit 1974. Pastaj vitet 80-ta janë karakteristike e një terrori sistematik që kanë përjetuar shqiptarët e Kosovës, sidomos pas demonstratave të fuqishme studentore të vitit 1981. Aq larg shkoi dhuna dhe terrori i shtetit jugosllav ndaj shqiptarëve sa që, ato pak të drejta që kishin fituar me kushtetutën e vitit 1974, iu mohuan në vitin 1989. Jugosllavia e bëri edhe hapin final politiko-juridik, eliminimin e statusit kushtetues të Krahinës Autonome të Kosovës, nga ana e Kuvendit të Serbisë, më 28 mars 1989. Pra ju suprimua Kushtetuta e Kosovës përmes aparatit policor dhe ushtarak. Në të njëjtën formë si ishte aneksuar Kosova në Kuvendin e Prizrenit të vitit 1945.

Edhe Shqipëria përjetoi kriza të vazhdueshme edhe pse ishte shtet me të gjitha të drejtat dhe njëhej ndërkombëtarisht. Por fatkeqësisht shteti shqiptar kishte ndjekur një politikë izolacioniste, çka do t'i kushtonte jashtëzakonisht shumë në të gjitha aspektet. Ky izolim i shtetit shqiptar do të shndërroj Shqipërinë në një shtet autarkik, të parin në Evropë.

Jugosllavia pikërisht në këtë periudhë kohore (1974-1989) arrin të shndërrohet një ndër shtetet më të fuqishme në rajon. Por duhet të theksohet edhe fakti tjetër, se është pikërisht perudha në fjalë, që ka filluar dekadencia e Jugosllavisë. Edhe përkundër se shteti shqiptar nuk arriti nivelin e zhvillimit, siç kishte arritur Jugosllavia, ajo kishte mjaft impakt politik në shtetin jugosllav sepse kishte një popullsi afërsisht tre milion banorë që kishin mbetur në kuadër të Jugosllavisë. E kur dihet mirëfilli se kishte shtete (republika) që përbënin e Jugosllavinë dhe nuk kishin qaj banorë, sa kishte shqiptarë në ish-Jugosllavi, ku vetëm në Kosovë pas vitit 1980 kishte mbërritur numri afër 2 milionë banorë. Prandaj, deshëm apo nuk deshëm ta pranojmë, stabiliteti politik i Jugosllavisë është varur edhe nga “minoriteti” shqiptar në ish-Jugosllavi. Për këtë arsye asnjëherë Tito nuk shkoi deri në atë masë sa që prishja e raporteve shqiptaro –jugosllave, të ishte e pariparueshme.

Periudha 1974-1989 ka pasur një dinamikë ngjarjeve, prandaj ka qenë tërheqëse edhe për studiues të huaj. Por nuk është trajtuar nga ky kënd nga i cili e ka trajtuar kandidati, pra nga prizmi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ku si kufi kohor siç kemi theksuar edhe më lart kemi marrë miratimin e Kushtetutës së Kosovës 1974 deri në suprimimin e saj 1989.

Metodologjia e kërkimit shkencor

Metodologjia shkencore me të cilën është shërbyer në këtë studim kandidati është ajo e qasjes tematike. Por duke mos lënë anash asnjë moment metodat tjera të kërkimi

shkencor, metoda e krahasimit, hulumtimit dhe përshkrimet tematike multidisiplinare. Përdorimit të këtyre metodave nga ana e kandidatit tregon se kandidati ka tentuar çdo herë për të ruajtur kohezionin, semantiken dhe aspektin kronologjik të punimit. Por, parimi bazë metodologjik ka qenë që të ruajmë paanshmërinë në interpretimin e dokumenteve arkivore dhe në krahasimin e literaturës.

Tema është realizuar në bazë të materialeve shkrimore që kanë të bëjnë me këtë temë. Janë trajtuar m burime të pabotuara dhe botuara, libra, materiale nga shtypi i kohës, si dhe burime nga interneti(me një kujdes shumë të madh) etj. Gjitha këto janë bashkërenditen sipas një kriteri kronologjik tematik, analitik, dhe krahasimtar. Punën time kërkimore- studimore e kam ndarë në dy faza. E para, mbledhje të dokumentacionit arkivor me vlerë për temën që kemi për studim, kryesisht në Arkivin e Shtetit në Tiranë, në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Në Agjencinë e Arkivave të Kosovës, si dhe kam siguruar materiale me vlerë edhe nga Arkivi i Lubjanës në Slloveni. I gjithë ky materiale është baza e studimit të temës time Doktorale. Faza e dytë, ka qenë mbledhja analizimi dhe krahasimi i një literature mjaftë voluminoze të autorëve të huaj dhe atyre vendor. Pas shumë analizave dhe krahasimeve kemi përdor për studim vetëm literaturë që kanë qenë me bazë të shendosh shkencore dhe të autorëve me impakt në fushën përkatëse. Në këtë fazë kemi shqyrtuar dhe shtypin ditor të kohës si dhe burimet nga internet.

Pra sa i përket trajtimit të kësaj teme, kandidati duke përdorë një shumëllojshmëri të metodave të kërkimit shkencor, që kanë qenë jetike për rezultatet sa më të mira shkencore për këtë temë. Dëshmon se kandidati ka bërë një punë të mirëfilltë shkencore gjatë trajtimit të kësaj teme të disertacionit.

Konkludimet e kandidatit Sahitaj rreth temës që ka pasur për studim

Në këtë studim “**Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989** ” kandidati ka qenë i fokusuar të nxjerrë përfundime sa më empirike për marrëdhëniet

shqiptaro-jugosllave 1970-1989 dhe ngjarjet që kanë karakterizuar këto marrëdhënie, gjatë periudhës në fjalë. Kur dihet se këtë periudhë kohore që ka pasë për studim, 1974-1989, kanë kulmuar disa ngjarje me rëndësi të madhe për shqiptaret e Kosovës. Si Kushtetuta e Kosovës 1974, këmbimet kulturore midis Shqipërisë dhe Kosovës 1970-1981, shpërthimi i demonstratave studentore në Kosovës 1981 dhe suprimimi i Autonomisë së Kosovës etj.. Duke pasur parasysh lidhshmërinë e këtyre ngjarjeve me ngjarjet tjera më thellë në histori, trajtimi është bërë duke filluar nga e përgjithshmja te e veçanta.

Edhe pse periudha e viteve 1970-1981, është trajtuar nga shumë studiues të huaj dhe vendor, por jo nga këndi që ka trajtuar në këtë studim studiuesi Sahitaj. Studimi është fokusuar në trajtimin sa më empirik të këtyre bashkëpunimeve midis shtetit shqiptar dhe atij jugosllav. Kryesisht duke u mbështetur në burime arkivore të proveniencës shqiptare, por edhe atyre jugosllave. Prandaj mund të konkludojmë më plotë të drejtë se këmbimet kulturore dhe arsimore midis Kosovës dhe shtetit shqiptar 1970-1981 kandidati ka arritur t'i prezantojmë në mënyrë mjaft të faktuara dhe argumentuese. Me lejohet si mentor të theksoj se nuk kam hasur akoma se dikush ka trajtuar deri me tani Këmbimet Kulturore, arsimore, artistike dhe sportive midis Kosovës dhe Shqipërisë 1971-1981, në kaq detale dhe duke u mbështetur kryekëput në dokumente arkivore.

Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur gjatë gjithë viteve të '70-a, në veçanti këmbimet midis shtetit shqiptar dhe Kosovës, por edhe determinizmin e mëvonshme të këtyre këmbimeve. Kjo periudhë dihet botërisht se ka qenë shumë me rëndësi për shqiptarët si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. Por duke pasur parasysh edhe rezultatet për këtë periudhë të kandidatit Sahitaj ne mundëm me thënë se është njëra ndër shtyllat kryesore të studimit të kandidatit.

Kandidati ka trajtuar me një qasje mjaftë akademike edhe Kushtetutën e Kosovës 1974. Duke ju referuar protagonistëve të kohës, studiuesve të asaj kohe (vendor dhe ndërkombëtar), si dhe studiuesve të më vonshëm. Pra trajtohet rrethanat që kanë qar në miratimin e kësaj Kushtetute, efektin që pati miratimi i Kushtetutës së Kosovës 1974 të qarqet nacionaliste serbe. Por edhe efektet pozitive që pati miratimi i kushtetues në jetën politike, kulturore, ekonomike etj..

Gjithë kjo etapë historike pra vitet e '70-a të shek. XX që karakterizohen me avancimet kushtetuese të Kosovës dhe me këmbimet kulturore, arsimore, shkencore dhe sportive me shtetin shqiptar u ndërpre në demonstratave të fuqishme studentore në mars-prill të vitit 1981.

Duke pasur parasysh edhe një ngjarje jo pa ndikim në jetën politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, që ka qenë determinues në ngjarjet e mëvonshme në ish-Jugosllavi vdekja e Titos në vitin 1980. Vdekja e Titos nuk ishte vdekje vetëm e një lideri, që mund të zëvendësohet me një tjetër pa u vërejtur kriza politike. Sepse Tito ishte vet ai i cili kishte krijuar Jugosllavinë komuniste dhe kishte qeverisur me të në mënyrë arbitrare afër 40 vjet. Për këtë ishte paraparë nga shumë analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjeostrategjike po ashtu edhe shumë shërbime të inteligjencës, si ato perëndimore dhe lindore, se pas vdekjes së Titos, Jugosllavia ka shumë gjasa të shkojë drejt shkatërrimit. Prandaj kandidati i ka dhënë hapësirë edhe kësaj ngjarje në studimin e tij, krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha të sipërthëna.

Shpërthimi i demonstratave studentore në Kosovë në vitin 1981 ishin shumë të fuqishme dhe të parat për nga përmasat në ish-Jugosllavi që nga Lufta e Dytë Botërore. Historianë të ndryshëm numërojnë me dhjetëra faktorë që kanë ndikuar në shpërthimin e këtyre demonstratave, por ato më relevante ishin kushtet e vështira ekonomike të shqiptarëve të Kosovës, në raport me popujt tjerë që përbënin ish-Jugosllavinë, si dhe avancimi i organizatave ilegale shqiptare, ngritja e vetëdijes kombëtare të rinia kosovare, sidomos pas atyre marrëdhënieve të bashkëpunimit që kishin pasur Kosova me Shqipërinë. Edhe pse demonstratat e vitit 1981 u shuan me dhunë, të përdorur nga aparati shtetëror jugosllav, për Kosovën lirisht mund t'i quajmë, për nga pesha dhe ndikimi që kishin, si ngjarja me e rëndësishme pas Lidhjes së Prizrenit 1878.

Se sa kishin demonstratat studentore ndikim në afirmimin e çështjes shqiptare, tregon jehona e tyre në arenën ndërkombëtare. Të gjitha mediat më të rëndësishme të kohës kanë shkruar për këto demonstrata. Të gjitha shtetet që sado pak kanë pasur interes për politikën ndërkombëtare janë interesuar për këto demonstrata dhe kanë tentuar që të marrin informata sa më të sakta në forma të ndryshme. Kishte shumë artikuj në mediumet botërore që kanë trajtuar demonstratat e vitit 1981, artikujt kanë pasur jehonë të madhe në botë, të

cilat ishin vlerësuar me pasazhe e komente pozitive, qoftë nga shtypi a diplomatë të ndryshëm ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që cekim më lartë. Kandidati gjatë studimit të demonstratave të vitit 1981 në këtë studim, kandidati ka trajtuar nga shumë kënde, pra si nga ai jugosllav, ndërkombëtar, kosovar dhe nga këndi i shtetit shqiptar. Çdo herë duke ballafaquar shumëllojshmërinë e studimeve për këto demonstrata. Por duke mos lënë anash dokumentet arkivore që ka arritur t'i siguro në arkivat e Shqipërisë dhe të Kosovës, edhe pse ka arritur shumë segmente të demonstratave 1981 t'i trajtoj në mënyrë sa më argumentuese. Kandidati nuk ka arritur të argumentoj 100% faktin se a ka pasur shteti shqiptar ndikim të drejtpërdrejt në shpërthimin e demonstratave studentore të vitit 1981 në Kosovë. Por kandidati sjellë mjaft fakte interesante rreth ndikimeve tjera që patën në shpërthimin e këtyre demonstratave, duke mos lënë anash as ndikimin e shtetit shqiptar.

Krejt këto fakte vijnë argumentuese pas analizimit të dokumentacioneve të ndryshme, kujtimeve të personaliteteve, që ishin protagonistë të politikës së kohës, si dhe analizimi i shumë studimeve për këto demonstrata, kandidati arrin në një konkludim për këtë element shumë të rëndësishëm të demonstratave të vitit 1981 se as nuk mund të mohohet, por as të pohohet, se a kishte shteti shqiptar drejtpërdrejt ndikim në shpërthimin e këtyre demonstratave.

Këto demonstrata përcollën mesazhe të qarta të gjitha shtresat, se tani Kosova kishte mjaftueshëm potenciale humane për të filluar të kërkonte të drejtat e saj në çfarë do forme dhe çfarëdo çmimi. Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë filluan shumë veprime me karakter kombëtar të organizuar në mënyrë kolektive, por demonstratat e vitit 1981 e fuqizuan unitetin i popullit shqiptar që të bashkuar të ecin drejt fitores, u ngrit mobilizim i ri, jo vetëm politik, shpirtëror i masave të gjera të popullit tonë. Shteti jugosllav, e kuptoi se populli i Kosovës kurrë nuk do t'i nënshtrohet sundimit serb-jugosllav. Jehona politike, kombëtare e demonstratave të vitit 1981 ishte strumbullari kryesor i fuqizimit të rezistencës kombëtare e cila në vitet e 80-ta fitoi përmasa të reja.

Të gjitha veprimet politike gjatë viteve të 80-ta të shtetit jugosllav, ishin nën afektin e demonstratave studentore të vitit 1981. Këto demonstrata serbët filluan t'i shfrytëzonin në maksimum për realizimin e qëllimeve të ndryshme politike, si për supremaci, serbocentrizëm

etj.. Për këtë dëshmon memorandum i Akademisë së Shkencave të Serbisë më 1986, djegia e Patrikanës së Pejës, rasti i Martinoviqit etj.. Krejt këto veprime politike të serbëve kurorëzohen me suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Edhe pse ishin bërë shumë përpjekje nga shqiptarët që të pengonin një gjë të tillë, përmes shumë demonstratave, dhe formave tjera, ku në vazhden e këtyre përpjekjeve ishte edhe greva e minatorëve në Trepçë. Por edhe përkundër të gjitha këtyre veprimeve nga pala kosovare, nuk arritën që ta pengonin suprimimin e autonomisë. Arsyeja kryesore se pse serbët ishin kaq këmbëngulës për ta suprimuar autonominë e Kosovës, ishte fakti se serbët donin të kishin më shumë argumente kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare, autonomia ishte një pengesë juridike në këtë drejtim. Për këtë dëshmon, kur pala serbe paraqet si argument para Komisionit të Badinterit në vitin 1991.

Po ashtu duke pasur parasysh zhvillime politike, ekonomike etj., kandidati me të njëjtin zell sjell mjaft fakte interesante për gjitha këto zhvillime. Krejt kjo përsëri duke u mbështetur kandidati në shumicën e rasteve në dokumente arkivore, dhe literaturë, ditaret e protagonistëve të kohës dhe shtypin e kohës etj..

Suprimimi i autonomisë së Kosovës është një nga ato ngjarjet e mëdha historike, që kanë karakterizuar Kosovën në fundin e shekullit XX. Për këtë arsye edhe ne kemi marrë si kufi kronologjik për temën që kemi për studim, pikërisht miratimin e Kushtetutës së Kosovës në vitin 1974 dhe suprimimin e saj 1989. Me këtë ngjarje përfundon ajo që kishte filluar më 1974 dhe fillon një etapë tjetër për Kosovën. Me suprimimin e autonomisë, Kosova hyn në periudhën e aparteidit.

Kandidati një hapësirë bukur të madhe i jep suprimimit të Autonomisë së Kosovës. Ky trajton faktorët që kanë qar në suprimim Autonomisë nga ana e serbëve. Jehonën e suprimimit Autonomisë në nivel vendi dhe në arenën ndërkombëtare. Grevën e minatorëve, demonstratat e vitit 1980. Po ashtu analizon me kujdes gjitha zhvillimet politike të asaj periudhe që patën ndikim të më vonshme gjatë periudhës së aparteidit. Edhe këtë segment me mjaft rëndësi të periudhës në fjalë autori e mbështet në dokumentacion arkivor, në shtypin e kohës por edhe në literaturë me kredenciale të larta shkencore.

Si konkludim mund të konstatojmë se kandidati në këtë studim disertacioni ka shënuar disa të arritura sa i përket studimit, analizimit të ngjarjeve më shumë rëndësi për

Kosovën dhe për Shqipërinë gjatë periudhës 1974-1989, (si dhe ngjarjet politike që kanë karakterizuar ish-Jugosllavinë). Si të këmbimeve kulturore dhe arsimore midis Kosovës dhe Shqipërisë, Kushtetutën e Kosovës 1974 dhe efektet e saj, demonstratat studentore 1981 në Kosovë dhe ndikimi i shtetit shqiptar në shpërthimin e tyre, gjendja politike, ekonomike e Kosovës 1981-1989, si dhe suprimimi e autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

Krejt kjo duke krahasuar dhe analizuar dokumentacionin autentik arkivor të papublikuar, dokumentet arkivore të botuara, gamën e gjerë të literaturës së shfrytëzuar, ditarët e personaliteteve të kohës, si dhe shtypin e kohës etj., gjitha kjo shumëllojshmëri e materialeve ka të bëjë me historinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, me Kosovën në qendër 1974-1989. Duke pasur parasysh të gjitha këto të sipërthëna besoj se ky studim është një kontribut modest në ndriçimin e kësaj periudhe historike me shumë rëndësi për shqiptarët, sidomos për shqiptarët që jetuan në ish-Jugosllavi.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Kontributi kryesor shkencor i kandidatit është se ka arritur të ndriçoj mjaft mirë me dokumente autentike arkivore disa prej ngjarjeve kryesor të kësaj periudhe. Duke pasur parasysh rëndësinë e Këmbimeve kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë 1971-1981 dhe ndikimin e tyre. Kandidati arrin të ndriçojë çdo segment të këtyre këmbimeve kulturore, arsimore, sportive etj.. Kryesisht duke u mbështetur në dokumente arkivore të arkivave të shteti shqiptar dhe arkivave të Kosovës.

Pastaj edhe është trajtuar mjaft interesant Kushtetuta e vitit 1974 ku kandidati ju referohet kryesisht literaturës të studiuesve shqiptar, serb dhe atyre ndërkombëtar. Duke argumentuar efektet e kësaj Kushtetute, si në aspektin pozitiv dhe negativ për shqiptarët e

Kosovës. Pastaj trajtohet edhe një segment interesant në këtë periudhë, reagimi i nacionalizmit serb ndaj Kushtetutës së vitit 1974.

Ajo që vërehet në krye të herës është fakti se kandidati ka trajtuar në mënyrë shumë interesante demonstratat studentore të vitit 1981. Janë trajtuar faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që kanë qar në shpërthimin e këtyre demonstratave. Ndikimin e shtetit shqiptar në këto demonstrata, reagimin e ish-funksionarëve shqiptar të Kosovës për demonstratat e vitit 1981. Krejt kjo duke u bazuar në dokumente arkivore si dhe duke ballafaquar studimet e studiuesve të huaj dhe atyre shqiptar. Prandaj ne mund të konstatojmë se ka bërë një studim të veçantë për këto ngjarje të rëndësishme të veçantë për shqiptarët e Kosovës.

Kandidati ka trajtuar edhe periudhën nga 1981 deri në 1989 me të njëjtën përkushtim çdo herë duke u mbështetur në burime arkivore, por për këtë periudhë pra 1981-1989, kandidati kësaj radhe përveç dokumenteve të arkiva të Shqipërisë dhe Kosovës, mbështet studimin e vet edhe në dokumente të Arkivit Qendror të Lubjanës . Pra trajtohen marrëdhëniet e shtetit shqiptar me ish-Jugosllavin pas vdekjes së Enver Hoxhës. Ndikimin e demonstratave studentore të vitit 1981 në ngritjen dhe fuqizimin e nacionalizmit shqiptar të Kosovës. Ashpërsimin e nacionalizmit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Fuqizimin politik të Slobodan Millosheviqit dhe metodat politike të tij. Ndikimin që kishte Akademia e Shkencave të Serbisë, Kisha Serbe në politikë bërjen e republikës së Serbisë.

Kandidati Sahitaj një trajtesë po ashtu të veçantë i ka bërë edhe Grevës së minatorëve dhe suprimimit të autonomisë së Kosovës. Duke trajtuar efektin e Grevës së minatorëve në zhvillimet politike. Pastaj rrjedhën e ngjarjeve politike që kanë qar në suprimimin e Autonomisë së Kosovës. Arsyet fundamentale që kanë qar në suprimimin e autonomisë së Kosovës. Efektet që krijojnë suprimimi i autonomisë së Kosovës në nivel vendi dhe në arenën ndërkombëtare.

Fushën shkencore në të cilën do të aplikohen të arritura e kandidatit

Të rejtat shkencore që ka sjellë kandidati mund të gjejnë zbatim në shumë fusha të e shkencave humane si: historike, politike, kulturore, arsimore etj.. Historike kuptohet sepse ky studim i takon kryekëput sferës historike, por kjo mund t`u hyrë në punë edhe studiuesve të fushave tjera siç edhe cekem më lartë. Studiuesve të shkencave politike, sepse munden me parë zhvillimet politike në ish-Jugosllavi, në Kosovë dhe në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Kurse për studiuesit e zhvillimit të arsimit mundën të hasin statistika mjaft interesante për zhvillimin e këtyre fushave.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen


Kandidati mundet që nga ky punim disertacioni **“Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989”** të botoj një studim të mirëfilltë historike për temën që ka pasur në studim për temë doktorate. Pra duke pasur parasysh volumin e kufizuar me standarde të punimit të doktoraturës, nuk ka pasë mundësi të ndalet edhe me në detale për disa segmente që kanë nevojë më shumë për t`u trajtuar. Por një gjë e tillë mundet kur të shndërron një vepër të botuar historike, që besojmë do të ishte një kontribut i mirë për periudhën në fjalë. Pra ky punim disertacioni mund të botohet si tersi, por mund edhe të merren segmente të saj si premisa për studime të veçanta.

Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturë **“Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989”** të kandidatit **MA. Sedat Sahitaj**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni recensues:


Prof. Dr. Fehari Ramadani (kryetar)




Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (antarë)




Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar)



Prof. Dr. Isak Sherifi (anëtar)



Prof. Dr. Nebi Dervishi (Mentor)



Tetovë, 30.04.2020.